

Shkaqet për arritjen e të mirave në këtë botë dhe në ahiret

1. Besimi në Allahun dhe bërja e veprave të mira (shkaku bazë).

Allahu thotë: "**Cilindo mashkull apo femër që kryen vepra të mira, duke qenë besimtar, Ne do ta bëjmë që të kalojë jetë të bukur dhe do ta shpërblejmë sipas veprave më të mira, që ka bërë.**" Nahl 97. Dhe thotë: "**Vërtet, për punëdrejtët është përgatitur e mira (Xheneti): kopshte dhe vreshta, vajza të reja, të së njëjtës moshë, dhe kupa të plota.**" Nebe 31-34. Dhe thotë: "**Për ata që ruhen (nga gjynahet), tek Allahu do të ketë kopshte të kënaqësive.**" Kalem 34. Dhe thotë: "**Me të vërtetë, ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, do të kenë për banesa kopshtet e Firdeusit...**" Kehf 107.

2. Pajisja me dije të dobishme (fetare).

Allahu na ka treguar se dija është shkak për ngritje në të dy botët. Allahu thotë: "**...ata që kanë besuar në mesin tuaj, Allahu i ngritë, e ata të cilëve u është dhënë dija i ngritë edhe më lartë**", Muxhadile 11, i ngritë në shkallë edhe më të larta. Dhe thotë: "**Thuaj: "A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?"**" Zumer 9. Dhe thotë: "**A është më mirë ai që shkon rrëshqanas e kokulur apo ai që ecën ballëlart në rrugën e drejtë?"**" Mulk 22. Dhe thotë: "**Vallë, ai që di se ajo që të është shpallur ty (Muhamed) nga Zoti yt është e vërteta, a është njësoj me atë që është i verbër ndaj këtij fakti? Vetëm njerëzit që kuptojnë ia vënë veshin kësaj.**" Rad 19.

Për të arritur dijen, Allahu ka treguar se duhet vepruar disa shkaqe. Ajo nuk vjen vetëvetiu, apo siç pretendojnë disa sekte se Allahu u jep dije edhe pa e kërkuar dijen. Prej shkaqeve përmendim:

- Të pyeturit e njerëzve që dinë (që kanë dije fetare) për ato gjëra që nuk i di. Allahu thotë: "**pyetni ata që dinë nëse ju nuk dini**" Nahl 43.

- Dhënia e mundit në kërkimin e dijes, mësimi i saj, në mënyrën më të mirë, e pastaj vijnë rezultatet. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: "**Dija arrihet veçse përmes mësimit dhe ëndrrat vijnë me ëndërrime.**" Dija nuk vjen vetë, por sa më shumë që mëson njeriu, arrin prej dijes dhe pajiset me të, kurse të shpresosh të kesh dije e të pajisesh me të duke ëndërruar, kjo mbetet vetëm ëndërr nëse nuk e realizon këtë në praktikë dhe nëse nuk e kërkon dijen.

3. Furnizimi (rrizku).

Prej Emrave të Allahut është err Rrezak - Furnizuesi. Kjo tregon se furnizimi është në Dorën e Allahut. Ai ka marrë përsipër furnizimin e robërve të Tij. Mirëpo, Allahu ka caktuar shkaqe për furnizimin, të cilat i ka sqaruar në Kuran dhe në sunetin profetik.

4. Mbështetja në Allahun

Nëse njeriu i mbështetet Allahut, e adhuron dhe i bindet Atij, kjo është shkak që Ai t'i mjaftojë atij. Kur Allahu i mjafton njeriut, është për qëllim se e ndihmon. Allahu thotë: "**A nuk i mjafton Allahu robit të Vet?!**" Zumer 36. Me "robit të Vet" është për qëllim ai njeri që e adhuron Allahun, që është rob i vërtetë i Tij, që i bindet Atij. Dhe thotë: "**Allahu i mjafton kujtdo që mbështetet tek Ai.**" Talak 3.

5. Ihsani, me dy llojet e tij.

Lloji i parë: në kuptimin e përkryerjes, ky lloj është në raport me Allahun. Besimtari duhet të mundohet që veprat e adhurimet e tij t'i kryejë në mënyrën më të përkryer, më të mirë, më të plotë.

Lloji i dytë: është në raport me krijesat, bamirësia ndaj tyre.

Allahu thotë: "**Vërtet, mëshira e Allahut është afër punëmirëve (bamirësve në raport me Allahun dhe krijesat).**" Dhe thotë: "**A ka shpërblim tjetër për të mirën, veç të mirës?!**" Rrahman 60. Nëse je bamirës ndaj të tjerëve, atëherë edhe Allahu do të jetë bamirës ndaj teje. Nëse mundohesh që adhurimet t'i kryesh në formën më të mirë e më të përkryer, Allahu do të ta japë shpërblimin më të plotë.

6. Devotshmëria dhe durimi me të tri llojet e tij.

Durim ndaj kryerjes së urdhrave të Allahut, durim në mosveprimin e mëkateve, durim përballë sprovave e fatkeqësive me të cilat goditemi. Allahu thotë: "**Fundi i lumtur i përket të devotshmëve (atyre që kanë frikë Allahun).**" Ta ha 132. Të jesh i bindur se, pavarësisht sprovave e vështirësive, me të cilat je goditur ti apo umeti, nëse e kemi frikë Allahun dhe ruhemë prej veprimt të mëkateve dhe hidhërimit e zemërimit të Allahut, atëherë fundi i lumtur na takon neve. Ky është premtim prej Allahut, e Ai nuk e shkel premtimin e Tij. Dhe thotë: "**Atë që ruhet (nga mëkatet) dhe bëhet i durueshëm, Allahu e shpërblen, se Ai kurrë nuk ia humb shpërblimin punëmirëve.**" Jusuf 90.

7. Lutja tek Allahu

Lutja tek Allahu që sa më shumë të të japë prej të mirave të Tij. Allahu thotë: "**Zoti juaj ka thënë: "Lutmuni Mua, se do t'ju përgjigjem!"** Gafir 60. Dhe: "**Vërtet, Zoti im i dëgjon lutjet!"** Ibrahim 39. "i dëgjon lutjet" në kuptimin: u përgjigjet lutjeve. Dhe: "**Kur robërit e Mi (besimtarë) të pyesin për Mua, (thuaju se) Unë jam afër, i përgjigjem lutjeve të lutësit, kur ai më lutet Mua.**" Bekare 186.

8. Pendimi, sinqerisht, për të gjitha mëkatet dhe lëshimet e bëra.

Allahu thotë: "**Vërtet, Unë jam Falës për atë që pendohet, beson e bën vepra të mira dhe pastaj qëndron në rrugë të drejtë.**" Ta ha 82. Që pendimi të jetë pranuar tek Allahu duhet të përmbushen disa shkaqe.

Në të gjitha këto shkaqe njeriu duhet t'i mbështetet Allahut e të kërkojë mbrojtje tek Ai.